

PROJEKTVENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KUSHTET DHE KRITERET E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË STACIONIT TË PLAZHIT”

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ndryshimet e fundit të ligjit 93/2015 “Për Turizmin” parashikojnë kushte dhe kritere të reja ligjore edhe për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazhit. Qëllimi parësor i projektvendimit “Për Miratimin e Rregullores “Për Kushtet dhe Kriteret e Ushtrimit të Veprimtarisë së Stacionit të Plazhit” është reflektimi i këtyre kërkesave të reja ligjore.

Po ashtu, ky projektvendim ka si qëllim përmirësimin e kushteve dhe standardeve për pushuesit nëpërmjet rritjes së nivelit të sigurisë në plazhe, shtimin e hapësirave të plazheve publike, vendosjen dhe ruajtjen e kushteve higjienike si dhe mbrojtjen nga ndotjet dhe dëmtimet në plazhet pranë deteve, liqeneve dhe lumenjve.

Në funksion të përmirësimit të situatës së plazhit të lejuar në favor të publikut, bazuar edhe në opinionin publik të pasqyruar në media, vlerësojmë rritjen e hapësirave të plazheve publike, bazuar edhe në konceptin se plazhi është pronë publike e patjetërsueshme. Konkretisht, referuar ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, “bregu i detit” është pronë publike e patjetërsueshme që i përkasin shtetit dhe bëjnë pjesë në pronat e paluajtshme publike (të pushtetit qendror dhe njësisive të qeverisjes vendore).

Më tej, bazuar në sa parashtroam më sipër, për të siguruar një menaxhim sa më të mirë të kësaj prone publike edhe për sezonin turistik 2024-2025, është ndërmarrë nisma që kërkesat nëpërmjet platformës *e-Albania*, për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi të vijojnë për t’u trajtuar nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB) deri në momentin e lidhjes së kontratave. Për rrjedhojë menaxhimi i procesit nga pikëpamja procedurale, nuk prek kompetencat e pushtetit vendor, pasi procesi kryhet në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore përkatëse.

Rregullorja e cila propozohet të miratohet me këtë projektvendim, përcakton kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacioneve të plazhit në të gjithë zonat bregdetare, si dhe në bregun e liqeneve e të lumenjve, të cilat janë identifikuar si zona të përshtatshme për plazhe, për një mjedis më të sigurt dhe të shëndetshëm për pushuesit në përputhje me objektivat të cilat synohen të arrihen.

Planifikimi i detajuar i zonës që do të përdoret për plazh si dhe përcaktimi i afateve në procesin e dhënies me qira të hapësirave të plazhit do ta bëjnë procesin më transparent dhe do të sigurojë zbatimin me rigorozitet të raportit plazh publik dhe privat.

II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave për fushën e turizmit, duke krijuar rritje të nivelit të sigurisë në plazhe dhe rritje të profesionalizmit në ofrimin e shërbimeve. Gjithashtu, propozimi i këtij projektakti është në përputhje me programin analitik të akteve të miratuara për vitin 2024 për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Hartimi i projektvendimit "Për Miratimin e Rregullores "Për Kushtet dhe Kriteret e Ushtrimit të Veprimtarisë së Stacionit të Plazhit" vjen si rrjedhojë e kërkesave të reja ligjore të ligjit 93/2015 "Për turizmin", i ndryshuar. Po ashtu, edhe si rrjedhojë e problematikave të hasura në terren në procesin e administrimit të stacioneve të plazhit dhe hapësirës bregdetare.

Problematikat në terren

Ndër problematikat më evidente listohet mosidentifikimi i qartë i hapësirës së plazheve publike apo keqpozicionimi i plazheve publike në raport me zonat e shërbimit përgjatë vijës bregdetare, çka i kthen ato në zona më pak të pëlqyeshme duke ulur cilësinë e ofertës që turistët marrin në plazhin publik. Pozicionimi i marginalizuar i plazheve publike përgjatë vijës bregdetare, në rastet kur nuk shërbehet siç duhet nga ana e njërive të vetëqeverisjes vendore sjell vështirësi në aksesueshmëri, prezencë të lartë mbetjesh dhe mungesë pajisjesh në pikat e vrojtimit të vijës bregujore.

Problematike kanë qenë edhe rastet e evidentuara ku hapësirat e plazheve publike janë zënë ose përvetësuar në mënyrë informale, apo edhe përdorimi i tyre në mënyrë abuzive nga subjekte të paregjistruara apo pa kontratë për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit;

Informaliteti mbetet një sfidë edhe në sektorin e akomodimit ku problematik mbetet operimi i strukturave akomoduese të paçertifikuara. Tashmë me zgjerimin e listës për llojet e strukturave të cilat mund të aplikojnë për certifikim, ky projektvendim ndihmon gjithashtu procesin e formalizimit të sektorit të akomodimit dhe e kthen administrimin e stacioneve të plazhit në një sektor mbështetës në funksion të shtimit të shërbimeve të ofruara nga strukturat akomoduese. Certifikimi i strukturave akomoduese është i nevojshëm për hartëzimin e ofertës akomoduese që Shqipëria ofron si edhe për identifikimin e cilësisë së kësaj oferte.

Vendosja e sinjalistikës së detyrueshme si edhe lista fikse e çmimeve për shezlongë shmanë problematikën e abuzimit me çmimet dhe e bën më të lehtë monitorimin e situatës së çmimeve në territor.

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit"

Shtimi i hapësirave publike dhe rritja e cilësisë së plazheve publike është efekti kryesor që ky projektvendim synon të arrijë. Mirëpozicionimi i segmenteve të plazheve publike do të rrisë cilësinë e plazhit të ofruar për qytetarët pa pagesë duke rritur sigurinë për pushuesit si dhe nivelin e higjienës në hapësirat e plazhit publik.

Ky projektvendim gjithashtu synon të rrisë gjithëpërfshirjen e pushtetit vendor dhe angazhimin e tij të plotë në menaxhimin e territorit të tij bregudor. Kjo qasje rrit gjithashtu angazhimin qytetar në respektimin e hapësirave publike në momentin që ato mirëevidentohen si të tilla.

Specifikimi i kushteve teknike sipas tipologjisë së plazheve lehtëson zbatimin në terren të rregullores. Detajimi i kushteve dhe kriterëve teknike ndihmon procesin e monitorimit dhe në rast mosrespektimi marrjen e masave administrative përkatëse. Identifikimi i qartë i strukturave akomoduese apo strukturave të shërbimeve si menaxhues të stacioneve të plazhit sjell gjithashtu reduktimin e informalitetit në ofrimin e tyre si shërbime mbështetëse.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është hartuar në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës dhe të nenit 64, pika 4 të ligjit nr.93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Ky projektvendim nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT:

Teksti i projektvendimit parashikon miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit dhe shtojcave bashkëlidhur që janë pjesë përbërëse të këtij projektvendimi. Gjithashtu parashikohet shfuqizimin e Vendimit nr. 171, datë 27.3.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, i ndryshuar. Në pikën 3 të projektvendimit parashikohen institucionet përgjegjëse që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, përfshirë strukturën përgjegjëse inspektuese në fushën e turizmit, të cilët do të verifikojnë respektimin e kushteve dhe kriterëve të përcaktuar në këtë projektakt.

Lidhur me tekstin e rregullores, në nenin 1 përcaktohet objekti i kësaj rregulloreje, i cili parashikon kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacioneve të plazhit në të gjitha zonat bregdetare, si dhe në bregun e liqeneve e të lumenjve, të cilat janë identifikuar si zona

të përshtatshme për plazhe, me qëllim ofrimin e kushteve dhe të standardeve cilësore për pushuesit.

Në nenin 2 janë dhënë përkufizimet për termat e përdorur në projektvendim dhe në rregulloren bashkëngjitur.

Në nenin 3 janë pasqyruar tipologjitë e plazheve përgjatë vijës bregdetare, të kategorizuar në plazhe të tipit A me përbërje ranore, B plazhi kryesisht me përbërje shkëmbore dhe zhavorri, AB është plazhi i ndërthurur, i cili përmban karakteristika si të tipave A e B dhe C është plazhi i virgjër, për përdorim të lirë, në të cilin nuk lejohet asnjë veprimtari për stacion plazhi, përveç mirëmbajtjes dhe pastrimit, nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

Me qëllim që subjektet të orientohen, të aplikojnë dhe të përzgjedhin zonën e plazhit për të cilën janë të interesuar të ushtrojnë aktivitetin "Stacion Plazhi", në nenin 4 është parashikuar që Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme Detare kanë detyrimin për përgatitjen e hartës së përgjithshme për plazhet e lejuara, e cila përmban hapësirat e plazhit për të ushtruar veprimtari si stacion plazhi, hapësirat e plazhit publik, hapësirën ujore të lejuar për notim (zonë e rrethuar me bova), si dhe vendbazimet e mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre.

Gjithashtu është përcaktuar edhe raporti i plazhit privat/publik që do të jetë sipas gjatësisë së vijës lineare të hartës së propozuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse, ku në çdo 1000 m vijë lineare, 300 m vijë lineare plazh të përcaktohen si parcela publike, shpërndarja e të cilave në hartë vlerësohet nga njësia e qeverisjes vendore rast pas rasti sipas tipologjisë së secilit plazh.

Po ashtu, është përcaktuar se harta e përgjithshme e plazheve të propozohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse dhe miratohet brenda muajit Tetor nga Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik.

Është vendosur afati për Agjencinë Kombëtare të Bregdetit në bashkëpunim me Njësinë e Vetëqeverisjes Vendore, që kontratat e qirasë së plazheve të jenë mbyllur brenda datës 1 maj të çdo viti, me qëllim dhënien kohë subjekteve për përmbushjen e detyrimeve sipas rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" duke e bërë procesin më transparent.

Plazhet për të cilat nuk është lidhur kontratë deri në datën e përcaktuar, funksionojnë si plazhe publike dhe administrohen/menaxhohen e mirëmbahen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Në nenin 5 përcaktohet përbërja dhe detyrat e Komitetit të Menaxhimit të Sezonit Turistik (KMST), ku mënyra e organizimit dhe funksionimit miratohet me urdhër të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit.

Neni 6 përcakton përgjegjësitë e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore sa i takon administrimit, menaxhimit, pastrimit dhe mirëmbajtjes të hapësirave të plazhit publik, pajisjen me infrastrukturën mbështetëse, mbledhjen e detyrimeve vjetore të qirasë dhe miratimin e vendbazimeve të mjeteve lundruese.

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit"

Në nenin 7 janë përcaktuar kriteret që duhet të përmbushin subjektet për të ushtruar veprimtarinë e stacionit të plazhit të cilat lidhin një kontratë qiraje për përdorimin e hapësirës së plazhit, në varësi të kapacitetit të strukturës akomoduese. Në rastin e kërkesave të projekteve me potencial strategjik apo kërkesave të investitorëve në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, kontrata për përdorimin e hapësirës së plazhit lidhet sipas akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse.

Në këtë nen është parashikuar që subjekti të plotësojë kriteret si: të jetë i regjistruar si person fizik/tregtar apo juridik për ushtrimin e veprimtarisë si strukturë akomoduese; të disponojë një strukturë akomoduese të kategorizuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, me hapësirë plazhi para/në afërsi të strukturës akomoduese; të ketë shlyer të gjitha detyrimet tatimore qendrore dhe detyrimet vendore; të ketë një plan operimi për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit. Pas përmbushjes së këtyre kriterëve, subjekti aplikon në portalin *e-Albania* duke ngarkuar dokumentacionin e nevojshëm sipas fazave që parashikon procedura e aplikimit.

Autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për dhënie në përdorim të stacioneve të plazhit është Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve (GTSHA), ku përbërja dhe mënyra e funksionit të tij miratohet me urdhër ministri. GTSHA shqyrton kërkesat e ardhura me dokumentacionin e ngarkuar nga aplikuesit sipas procedurës së përcaktuar në rregullore, miraton kërkesën në portalin *e-Albania* dhe AKB njofton menjëherë subjektin dhe NJVV-në për nënshkrimin e kontratës për dorëzimin e hapësirës së plazhit.

Kontrata për dhënie në përdorim të hapësirave të plazhit nënshkruhet me afat nga 1 (një) deri në 5 (pesë) vjet dhe stacioni i plazhi dhe periudha brenda të cilës ushtrohet veprimtaria e stacionit të plazhit është nga 1 maj deri më 15 nëntor të çdo viti. Në rast se subjekti ushtron veprimtarinë gjatë kësaj periudhe ofron të gjitha shërbimet dhe përmbushen të gjitha kushtet minimale të përcaktuara, në bazë të tipologjisë së plazhit ku do të ushtrohet aktiviteti.

Gjithashtu, në funksion të rritjes së sigurisë, përpara nënshkrimit të kontratave, subjektet do të kenë detyrimin të vete deklarojnë se njohin dhe mbajnë përgjegjësi të plotë për plotësimin dhe zbatimin e të gjitha kushteve, kriterëve dhe kërkesave për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit të parashikuar në këtë projektvendim. Në rast se moszbatimi i këtyre kërkesave sjell dëme të rënda për shëndetin, subjektet ngarkohen me përgjegjësi penale.

Në varësi të tipologjisë së plazhit, në nenin 8 të kësaj rregulloreje, përcaktohen kushtet minimale të standardeve teknike që duhet të përmbushë një stacion plazhi, të tilla si: distanca midis çadrave, pajisja me dushe, tualete, dhoma veshjeje, etj. Një rëndësi e posaçme i është kushtuar paisjes së stacionit të plazhit me zonën e ndihmës së shpejtë në shërbim të pushuesve, pajisjet përkatëse për dhënie e ndihmës së shpejtë për pushuesit dhe zona e ndihmës së shpejtë duhet të jetë lehtësisht e aksesueshme dhe e identifikueshëm, ku të lihen korridore të lira kalimi për transportin në raste emergjence. Po ashtu, është parashikuar edhe prania e tabelave informuese, të vendosura në vende të dukshme, me numrat e telefonit të Ambulancës, Policisë, Zjarrfikëses, Kapitenerisë së Portit, QNOD.

Konkretisht kushtet minimale që duhet të përmbushë një stacion plazhi janë, si më poshtë vijon:

Në plazhet e tipit A,

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit"

- a) për çadrat dhe ndenjëset e pushuesve të respektohet një distancë prej të paktën 10 (dhjetë) m nga vija e bregut të detit, liqenit;
- b) hapësira prej 2.5 (dy pikë pesë) m përpara brezit të parë të çadrave të jetë e lirë për t'u shfrytëzuar nga publiku;
- c) hapësira midis çadrave (nga çadra në çadër) nuk duhet të jetë më e vogël se 3 (tre) m në linjë horizontale me vijën e ujit, si dhe jo më e vogël se 2.5 (dy pikë pesë) m në linjë vertikale me vijën e ujit;
- ç) të ketë në dispozicion të pushuesve 1 (një) dush me ujë të ëmbël;
- d) të jetë i pajisur me shërbime higjienike, minimalisht të ketë 1 tualet të ndarë në njësi për femra dhe meshkuj dhe 1 (një) për njerëzit me aftësi të kufizuara; njësia për njerëzit me aftësi të kufizuara mund të përfshihet në secilën njësi për femra dhe meshkuj, duke rritur sipërfaqen e këtyre njësive të shërbimit në dimensionet maksimale 1,80 m x 1,80 m;
- dh) të ketë kabina zhveshjeje, sipërfaqja totale e kabinave të zhveshjes nuk duhet të jetë më e vogël se 1 (një) % e sipërfaqes së hapësirës së plazhit të dhënë në përdorim;
- e) të jetë i pajisur me zonën e ndihmës së shpejtë në shërbim të pushuesve, si dhe me pajisjet përkatëse për dhënien e ndihmës së shpejtë për pushuesit; ky ambient duhet të jetë lehtësisht i aksesueshëm dhe i identifikueshëm dhe të lihen korridore të lira kalimi për transportin në raste emergjence;
- ë) prania e tabelave informuese, të vendosura në vende të dukshme, me numrat e telefonit të Ambulancës, Policisë, Zjarrfikëses, Kapitanerisë së Portit, QNOD-it;
- f) të jetë i pajisur me kontejnerë dhe kosha me kapak për hedhjen e mbeturinave;
- g) çdo çadër duhet të jetë e pajisur me 2 (dy) krevate plazhi;
- gj) afishimit të kritereve dhe kushteve të sigurisë së shëndetit dhe jetës për aspektet teknike të veprimtarisë së stacionit të plazhit.
- h) të ekspozojë në vend të dukshëm për publikun emrin e biznesit, si dhe procedurën e ankimit të paktën në gjuhën shqipe dhe angleze.
- i) të ekspozojë dukshëm listat e çmimeve për produktin dhe shërbimin që ofron të paktën në gjuhën shqipe dhe angleze.
- j) stafi që shërben pranë stacioneve të plazhit të ketë uniforme dalluese;
- k) të zbatojë kodin e etikës globale në fushën e turizmit;
- l) detyrimin të mirëmbajtje dhe të parandalojë ndotjen e hapësirës së plazhit që ka marrë në përdorim nëpërmjet shërbimit për pastrimin dhe mirëmbajtjen e stacionit të plazhit të jetë ditor, në mëngjes dhe në mbrëmje pas mbylljes së plazhit. Po ashtu, gjatë orarit të hapjes së stacionit të plazhit duhet të sigurohet vazhdimësia e pastërtisë dhe boshatisja e koshave të mbeturinave;

ll) në të gjithë territorin e plazhit ndalohet vendosja e elementeve ndarëse, gardhe apo të tjera të ngjashme me to.

Në plazhet e tipit B,

- a) për çadrat dhe ndenjset e pushuesve ne varësi të hapësirës, të respektohet një distancë prej 2.5(dy pikë pesë) -3 (tre) m nga vija e bregut të detit, liqenit;
- b) hapësira midis çadrave (nga çadra në çadër) duhet të jetë të paktën 2.5 (dy pikë pesë) m;
- c) të gjitha kushtet e përcaktuara për tipin A, në pikën 1, përveç shkronjave “b” dhe “c”.

Në plazhet e tipit AB,

- a) për hapësirat, të cilat përmbajnë elementet e tipologjisë së plazhit të tipit A, do të zbatohen kriteret e plazhit të tipit A, sipas pikës 1, të këtij neni;
- b) për hapësirat, të cilat përmbajnë elementet e tipologjisë së plazhit të tipit B, do të zbatohen kriteret e plazhit të tipit B, sipas pikës 2, të këtij neni.

Për plazhin e tipit C, njësia e vetqeverisjes vendore merr masa për vendosjen e tabelave informuese, të vendosura në vende të dukshme, me numrat e telefonit të Ambulancës, Policisë, Zjarrfikëses, Kapitaneisë së Portit, QNOD-it;

Neni 9, ka si qëllim ndër të tjera, të garantojë mirëmbajtjen, ruajtjen e kushteve higjienike dhe plotësimin e të gjitha kushteve të nevojshme për mirëadministrimin e gjithë hapësirës së stacionit të plazhit, duke përfshirë pastërtinë e detit dhe bregut të detit për zonën para stacionit të plazhit.

Kërkesat për sigurinë të përcaktuara në këtë nen zbatohen edhe për plazhet publike.

Po ashtu në këtë nen përcaktohen kërkesat për sigurinë fizike në stacionet e plazhit. Për çdo 80 m në vijë lineare është parashikuar një pikë vrojtimi e pajisur me vrojtues plazhi dhe mjetet e nevojshme si dhe pajisjen me kullë vrojtimi në plazhet publikë dhe me vrojtues plazhi. Në rast se distanca midis stacioneve të plazhit është mbi 80 m, atëherë pika e vrojtimit do të sigurohet për çdo fraksion 80 m linear, ndërsa edhe stacionet e plazhit me vijë lineare nën 80m kanë detyrimin të kenë vrojtues plazhi.

Në përmbajtje të këtij neni parashikohet si detyrim vendosja e sinjalistikës nëpërmjet:

-sinjalizimit dhe kufizimit me bovave pluskuese me ngjyrë të kuqe të cilat duhet të jenë të mirankoruara dhe të kontrollohen periodikisht nëse ato kanë lëvizur nga pozicioni i tyre nga dallgët, era apo shkaqe të tjera.

-sinjalizimit të zonave të përdorimit të mjeteve lundruese për argëtim, zonave për përdorimin dhe ankorimin e mjeteve lundruese me ose pa motor.

-sinjalizimit me tabela informuese në shqip dhe në anglisht, në vend të dukshëm pranë bregut të detit “Zonë e ndaluar për notim”;

-vendosjes së flamujve me shkop në përputhje me kushtet e motit dhe të detit, i cili mund të ndryshohet gjatë ditës, nëse ndryshojnë kushtet e motit apo të detit.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”

Të gjitha stacionet e plazhit duhet të garantojnë shërbimin me Vrojtues Plazhi, për gjatë gjithë kohës që subjekti ushtron aktivitetin e tij, në funksion të garantimit të sigurisë së shëndetit dhe jetës së pushuesve.

Në nenin 10 parashikohen detyrat e vrojtuesit të plazhit duke vënë theksin tek njohuritë mbi kuadrin ligjor të funksionimit të stacionit të plazhit, teknikat e shpëtimit dhe dylyftimit në ujë, dhënien e ndihmës së parë mjekësore etj. Detyrimin për të qenë i angazhuar ekskluzivisht në shërbim të vrojtimit-shpëtimit dhe sigurimin e prezencës së tij për gjatë gjithë kohës pranë pikës së vrojtimit.

Me qëllim që pas përfundimit të afatit vjetor të përdorimit të plazhit, plazhet të rikthehen në gjendjen e tyre natyrore, në nenin 11 parashikohen karakteristikat e strukturave të ndërtuara, në mënyrë që të jenë lehtësisht të çmontueshme.

Respektimi i kushtit për nivelin e lejuar të zhurmave është një tjetër komponent që synohet të përmirësohet nëpërmjet këtij projektvendimi, duke detyruar të gjithë subjektet që marrin me qira hapësira plazhi, të respektojnë normat në nivelin e lejuar të zhurmave, siç përcaktohet në nenin 12.

Në nenin 13 është parashikuar roli aktiv i strukturës përgjegjëse inspektuese në fushën e turizmit për verifikimin e zbatimit të kushteve dhe kriterëve të vendosura në këtë rregullore. Në rast konstatimi të shkeljeve të rënda apo të përsëritura, struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e turizmit merr masa administrative në përputhje me parashikimet e nenit 71 të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar dhe në rast përsëritje të shkeljeve administrative deri në zgjidhjen e menjëhershme të kontratës.

Neni 14 përcakton se përjashtimisht për bashkinë Fier dhe Divjakë, në stacionet e plazhit, që nuk ka struktura akomoduese pranë apo në afërsi të hapësirës së plazhit, nuk zbatohet kriteri i parashikuar në shkronjën “b”, pika 3, e nenit 7 dhe subjekti, përveç kriterëve të parashikuara në shkronjat “c” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 7, duhet të plotësojë kriteret si: të jetë i regjistruar si person fizik / tregtar apo juridik, për ushtrimin e veprimtarisë si strukturë shërbimi si dhe të disponojnë një strukturë shërbimi me kapacitet mbi 20 tavolina dhe të ketë hapësirë plazhi, pranë strukturës së shërbimit. Ky nen parashikon edhe procedurën për paraqitjen e kërkesës dhe shqyrtimit të aplikimit.

Subjektet, të cilët kanë kontratë të vlefshme qiraje/përdorimi të hapësirave të stacionit të plazhit, deri në vitin 2025, do të zhvillojnë aktivitetin e tyre deri në përfundimin e afatit të kontratës, duke respektuar kushtet dhe kërkesat e parashikuara në këtë rregullore.

Bashkëlidhur këtij projektvendimi dhe pjesë përbërëse e tij janë shtojcat si vijon:

SHTOJCA 1 - Kontrata model për përdorimin e hapësirës së plazhit / Kontratë qiraje;

SHTOJCA 2 - Pika e vrojtimit duhet të ketë këto pajisje;

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E VENDIMIT

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”

Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e turizmit, Drejtoria e Përgjithshme Detare, Policia Kufitare dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.


VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Për hartimin e këtij projektvendimi kanë kontribuar Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Turizmit, Sektori i Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i projektvendimit nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit, pasi të gjitha shpenzimet mbulohen nga subjektet.

MINISTRI I TURIZMIT DHE MJEDISIT



Mirela KUMBARO FURXHI